



Institut für Vergleichende und
Indogermanische Sprachwissenschaft sowie
Albanologie

LUDWIG-MAXIMILIAN UNIVERSITÄT



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj

Tryezë shkencore

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, me bashkëpunimin e *Institutit për Gjuhësi të Krahasuar e Indoeuropiane si dhe Albanologji* (Universiteti Ludwig Maximilian, Mynih), organizojnë tryezën shkencore *Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj*, në datat 4-5 nëntor 2024.

Korniza shkencore e tryezës:

Në kontekstin e studimeve të fundit *mbi origjinën e gjuhëve indoeuropiane dhe mbi lëvizjet migratore drejt Europës, të mbështetura në metoda të kombinuara matematike-statistikore, gjuhësore e gjenetike*, së bashku me rezultatet e reja të natyrës kronologjike që dalin prej tyre; si edhe me arritjet e studimeve etimologjike për fondin e trashëguar indoeuropian të shqipes në projektet aktuale për shqipen e vjetër, organizatorët kanë menduar të nxisin një diskutim ndërdisiplinor për origjinën, vendin e shqipes në qerthullin e gjuhëve indoeuropiane, si dhe për fazat e evolucionit të saj në kohë dhe hapësirë.

Ndër temat që propozohen për t'u bërë pjesë e diskutimit janë:

- 1. Origjina e shqipes në kontekstin historik dhe parahistorik ballkanik;***
- 2. Shqipja si gjuhë indoeuropiane;***
- 3. Koha e shkëputjes së shqipes nga trungu i përbashkët proto-indoeuropian;***

4. *Bashkëpërkime dy-a më shumë-palëshe të shqipes me gjuhë indoeuropiane (në fondin leksikor, nënsistemin fonetik e gramatikor);*
5. *Periodizimi i evolucionit tëshqipes në kohë dhe hapësirë.*

Janë të mirëpritura edhe diskutimet e nxitura nga rezultatet e gërmimeve arkeologjike të kohëve të fundit, si p.sh. ato të kryera në zonën e Liqeneve të Ohrit dhe të Prespës.

Tryeza do të mbahet në mjediset e Akademisë së Shkencave, në dy seanca, secila prej tyre me nga një folës kryesor (keynote speaker) dhe 5-6 pjesëmarrës me kumtesa dhe diskutime.

Pjesëmarrës në tryezë do të jenë rreth 15 studiues nga fusha e indoeuropianistikës dhe e albanologjisë, si dhe autorë të studimeve të fundit mbi origjinën e gjuhëve indoeuropiane. Do të jenë të ftuar si dëgjues studiues të fushave të ndryshme në shkencat albanologjike.

Komiteti shkencor-organizues:

Anila Omari (kryetare), Bardhyl Demiraj, Adem Bunguri, Mimoza Kore, Ledio Hala (koordinator).